



# Raport vjetor

# 2013

---



## Përmbajtja

<b>Sfondi.....</b>	<b>- 2 -</b>
<b>Programet kryesore.....</b>	<b>- 2 -</b>
(1) <i>Demokratizimi dhe praktikat parlamentare (DPP).....</i>	<i>- 2 -</i>
(2) <i>Qeverisja lokale dhe pjesëmarrja qytetare.....</i>	<i>- 2 -</i>
(3) <i>Transparenca dhe kundër korrupsioni.....</i>	<i>- 3 -</i>
(4) <i>Zgjedhjet e lira dhe të drejta.....</i>	<i>- 3 -</i>
<b>Projektet aktuale .....</b>	<b>- 5 -</b>
(5) <i>Përfshirja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie në qeverisjen locale.....</i>	<i>- 5 -</i>
(6) <i>Transparenca dhe llogaridhënia në prokurimin publik .....</i>	<i>- 5 -</i>
(7) <i>Pjesëmarrja qytetare për transparencë dhe llogaridhënie.....</i>	<i>- 6 -</i>
(8) <i>Agjencionet e pa (varura) dhe ndërmarrjet publike në Kosovë.....</i>	<i>- 7 -</i>
(9) <i>10 vite parlamentarizëm.....</i>	<i>- 8 -</i>
(10) <i>Zgjedhjet e lira dhe të drejta.....</i>	<i>- 8 -</i>
(11) <i>Gratë për të drejta dhe përgjegjësi më të mëdha në zgjedhje.....</i>	<i>- 9 -</i>
(12) <i>Monitorimi dhe avokimi për zbatimin e planeve lokale të veprimit të komunitetit RAE në Prizren .....</i>	<i>- 10 -</i>
(13) <i>Rritja e aktivizmit në komunitetet lokale dhe në vendimmarrje.....</i>	<i>- 11 -</i>
<b>Struktura organizative .....</b>	<b>- 12 -</b>
(14) <i>Bordi i Drejtorëve.....</i>	<i>- 12 -</i>
(15) <i>Anëtarët e stafit.....</i>	<i>- 12 -</i>
<b>Origjina e fondeve .....</b>	<b>- 15 -</b>
<b>Pasqyrat financiare .....</b>	<b>- 16 -</b>



## Sfondi

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është organizatë jo qeveritare e themeluar në Prill të vitit 2005, përmes mbështetjes së Programit për Pjesëmarrje Qytetare të National Democratic Institute (NDI). KDI ka përvijë të gjatë në zhvillimin e kapaciteteve të shoqërisë civile, në proceset zgjedhore, si dhe monitorimin Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendeve Komunale. Misioni i KDI është të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve të shtetit.

## Programet kryesore

### Demokratizimi dhe praktikat parlamentare (DPP)

Programi për demokratizim dhe praktika parlamentare vazhdon të shërbej si urë lidhëse në mes të Kuvendit dhe qytetarëve, përmes nxitjes së dialogut në mes të zgjedhësve dhe të zgjedhurve, si dhe fuqizimin e votuesve për të mbajtur të përgjegjshëm dhe për të kërkuar llogari nga të zgjedhurit e tyre. DPP mbështetë zhvillimin e demokracisë dhe praktikave parlamentare, duke inkurajuar, mobilizuar dhe koordinuar pjesëmarrje më të madhe qytetare në vendimmarrje dhe përfshirje të organizatave të shoqërisë civile në aktivitete të avokimit, për një bazë sa më të gjerë qytetare në mënyrë që të ndikohet në orientimin dhe hartimin e ligjeve dhe politikave nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kontributi i DPP për reformat dhe demokratizimin e Kuvendit bëhet përmes raporteve periodike të vlerësimit, përgatitjes së analizave të politikave, takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të zgjedhur dhe qeveritar, organizimit të tryezave për përballje mes qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur në nivele të ndryshme, vlerësimit të performancës individuale të deputetëve, grupeve parlamentare dhe Kuvendit si institucion. Përmes implementimit të këtij programi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) do të vazhdojë të kontribuoj në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve demokratike të Kosovës, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset demokratike.

### Qeverisja lokale dhe pjesëmarrja qytetare

Në kuadër të angazhimeve për të avancuar qeverisjen lokale, KDI ka ndërtuar partneritet me 11 OSHC nga komuna të ndryshme të Kosovës, duke u ndihmuar atyre që të nxisin institucionet lokale që të zhvillojnë konsultime publike dhe të rrisin transparencën në proceset vendimmarrëse. Në total, KDI ka monitoruar punën e 18 komunave, respektivisht mbi gjysmën e komunave të Kosovës, nga të cilat 6 drejtpërdrejt dhe 12 përmes organizatave partnere. KDI ka trajnuar organizatat partnere për monitorimin e kuvendeve komunale në mënyrë sistematike, duke u përqendruar në realizimin e premtimeve zgjedhore, respektimin e ligjeve për qeverisje lokale, identifikimin e çështjeve me prioritet për komunitete të caktuara në kuadër të komunës, dhe avokimin për këto çështje pranë institucioneve përkatëse të pushtetit lokal. Në linjë me synimin për të fuqizuar pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen lokale, KDI ka themeluar Grupin Këshillues të OSHC-ve për Qeverisje Lokale, për të organizuar shoqërinë civile rreth çështjeve kryesore që ndërlidhen me qeverisjen lokale. Duke marrë parasysh që viti 2013 ka qenë vit zgjedhor, organizatat partnere të KDI kanë monitoruar dhe publikuar premtimet zgjedhore të kryetarëve të zgjedhur të komunave, në mënyrë



që nga ta të kërkohet llogari gjatë mandatit në vijim. Gjithashtu, për të gjitha komunat që ka monitoruar, KDI ka publikuar raportin vjetor për Qeverisje Lokale ku ka vlerësuar nivelin e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare në hartimin e politikave lokale. KDI ka vazhduar me publikimin e fletënotimeve për kuvendet komunale të rajonit të Prizrenit, ku është vlerësuar performanca e këshilltarëve komunal. Përveç përpjekjeve për fuqizimin e OSHC-ve lokale dhe publikimit të vlerësimeve mbi punën e institucioneve lokale, KDI ka publikuar një sërë rekomandimesh që kanë pasur për synim të ndihmojnë në ndërtimin e institucioneve demokratike, të hapura dhe efikase të pushtetit lokal.

## **Transparenca dhe kundër korrupsioni**

Programi për transparencë dhe kundër korrupsion (TK) i Institutit Demokratik të Kosovës, është themeluar me synimin për të ndikuar në promovimin e kulturës kundër-korrupsionit, eliminimin e praktikave korruptive, dhe krijimin e një ambienti ku dominojnë institucionet me integritet të lartë, të cilat do të jenë në gjendje të ndërmarrin masa efikase kundër korrupsionit, si në organizatat publike ashtu edhe në ato private. TK është i përkushtuar që të ndikoj në ndërtimin dhe zbatimin e kornizës ligjore, bazuar në parime të një shoqërie demokratike ku sundon ligji, ku ndërmerren masa kundër korruptive për një qeverisje transparente dhe në shërbim të qytetarëve. TK ndihmon në nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në luftën kundër-korrupsionit, dhe në rritjen e kapacitetit të viktimave dhe dëshmitarëve të korrupsionit për të adresuar dhe raportuar ankesat e tyre, e të cilat më vonë synon t'i shëndrroj në ndryshime të politikave institucionale për të përmirësuar qeverisjen. TK promovon dialogun mes shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare, ku përmes aktiviteteve avokuese ndikon në ngritjen e vullnetit politik dhe nismave të nevojshme legjislative për krijimin e bazës ligjore dhe mekanizmave funksional që mundësojnë parandalimin dhe mënjanimin korrupsionit. TK ndikon në sensibilizimin e qytetarëve përmes të gjeturave nga proceset e monitorimit, hulumtimeve dhe analizave, të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin e shkallës së zbatimit të ligjeve kundër korrupsionit, duke informuar qytetarët për nivelin e përgjegjshmërisë së zyrtarëve të zgjedhur dhe transparencën e institucioneve. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), përmes partneritetit me Transparency Internatioanal (TI), zotohet të qëndroj i përkushtuar në synimin për të krijuar një shoqëri të lirë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, duke përhapur vlerat universale të një shoqërie demokratike me mbikëqyrje qytetare, duke garantuar një qeverisje të mirë, të përgjegjshme, transparente, dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve.

## **Zgjedhjet e lira dhe të drejta**

Si organizatë udhëheqëse e koalicionit të OJQ-ve për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim (DV)", KDI ka qenë e përfshirë në organizimin e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve lokale të mbajtura në vitin 2013. Në bashkëpunim me 11 organizatat tjera që janë pjesë e koalicionit, KDI ka rekrutuar, trajnuar dhe angazhuar 50 vëzhgues afatgjatë për të monitoruar fushatën parazgjedhore, dhe 1600 vëzhgues për të vëzhguar procesin zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, dhe garën e balotazhit. Pas përfundimit të balotazhit, DV ka dorëzuar 10 ankesa zgjedhore në PZAP. DV ka mbledhur dëshmitë për këto ankesa përmes 25 vëzhguesve mobil të cilat i janë përgjigjur raporteve të vëzhguesve statik për shkeljet e rregullave zgjedhore. Të dhënat e dërguara nga vëzhguesit në qendrën e thirrjeve të DV, janë analizuar nga 2 ekspert ligjor të cilët më pas kanë



përgatitur ankesat. Para zgjedhjeve, KDI në bashkëpunim me partneret tjerë në DV kanë implementuar një fushatë të gjerë për edukimin e votuesve. KDI ka publikuar dhe shpërndarë më shumë se 100.000 broshura me moton “Voto dhe Vëzhgo” (70.000 në gjuhën shqipe dhe 30.000 në gjuhën Serbe, për pjesëtarët e komunitetit serb). Të katër faqet e broshurave përmbanin informata mbi të drejtën për të votuar, procesin e votimit për kryetar të komunave dhe këshilltar komunal si dhe procesin e raportimit të ankesave mbi procesin zgjedhor në PZAP dhe DV. Gjithashtu, me iniciativë të KDI, aktorë të njohur Kosovar kanë realizuar një shfaqje para ndërtesës së Qeverisë (Bulevardi Ibrahim Rugova), duke portretizuar parregullësitë më të shpeshta të proceseve të mëparshme zgjedhore. Kjo shfaqje kishte për synim informimin e qytetarëve për gjërat që nuk janë të lejuara në procesin zgjedhor, për zgjedhjet lokale të 3 Nëntorit, 2013. Pas përfundimit të procesit zgjedhor, KDI dhe partnerët tjerë në DV kanë publikuar raportin mbi vëzhgimin e zgjedhjeve, ku kanë shpalosur të gjeturat nga misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve dhe rekomandimet për organet përgjegjëse për menaxhimin e zgjedhjeve.

## **Gratë për të drejta dhe përgjegjësi më të mëdha në zgjedhje**

Si udhëheqëse e Koalicionit Demokracia në Veprim, KDI ka implemtuar programe të veçanta për edukimin e votuesve, e që kanë pasur në shënjestër gratë. Rrjeti i DV ka shërbyer si mekanizëm efikas për të mbledhur këshilltarët komunal, OJQ-të lokale të grave dhe OJQ-të tjera, si dhe mediat lokale në debatet rajonale, debatet në radio dhe aktivitetet tjera të zhvilluara në tërë Kosovën. KDI ka ofruar mbështetje teknike dhe financiare për shtatë (7) OJQ të grave, në formë të granteve të vogla dhe trajnimeve, në mënyrë që këto organizata t’u qasen grave në zonat rurale dhe të implementojnë programe të edukimit për procesin zgjedhor dhe rëndësinë që gratë të marrin pjesë të pavarura në procesin zgjedhor. Në kuadër të përpjekjeve për të informuar gratë rreth procesit zgjedhor KDI ka realizuar edhe një spot televiziv ku emra të njohur të estradës kanë dhënë mesazhe mbi përfaqësimin e barabartë gjinor në procesin zgjedhor. Ky spot televiziv është transmetuar në RTK 1, dhe përmes medieve sociale. Spoti përfshinte mesazhe të cilat u drejtoheshin grave si votuese, si qytetare, si nëna dhe bashkëshorte, e që potencialisht mund të jenë të prekura nga fenomeni i “votimit familjar”. Një nga episodet e serialit të popullarizuar “Kafeneja Jonë”, i është kushtuar tërësisht çështjes së të drejtave të grave në zgjedhje dhe rëndësinë e parimit të votimit të pavarur. Gjatë serialit koncepti i “votimit familjar” ishte dekonstruktuar dhe adaptuar në fjalorin jo formal dhe jo politik. Fushata “Nuk ka demokraci me një gjini”, ishte lansuar përmes Facebook, në mënyrë që kjo temë të qarkulloj në rrjetet sociale dhe të promovoj aktivitetet e projektit. Gjithashtu, vullnetarët e DV kanë realizuar edhe fushatën Derë më Derë, duke shpërndarë broshura në të gjitha rajonet, komunat dhe fshatrat e Kosovës. Përveç organizatave partnere, DV bashkoi forcat edhe me Hope Felloëship, për të organizuar debate me studentët e Universitetit Amerikan në Kosovë. Gjatë këtyre debateve votuesit e rinj kishin mundësinë të diskutojnë për mentalitetin demokratik të zgjedhjeve të drejta, ku barazia dhe gjithpërfshirja janë perspektivat kryesore.



## Projektet aktuale

### Përfshirja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie në qeverisjen lokale

Synimi i projektit ka qenë rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale në 14 komuna (duke mbuluar 7 rajonet). KDI ka përgatitur mekanizmat për monitorimin e institucioneve të nivelit lokal dhe ka ofruar fonde bazike, për OSHC të caktuara në mënyrë që ato të ndërmarrin fushata sistematike të avokimit.

#### Grupi i shënjestruar

Grupi i shënjestruar nga ky projekt përbëhet nga 11 organizata lokale të shoqërisë civile të bazuar në komunitet. Ideja e projektit ishte të ndihmohen OSHC-të në përvetësimin e shkathtësive dhe ekspertizës për monitorim dhe avokim në institucionet ekzekutive dhe legjislativ të komunës.

#### Fushëveprimi i shërbimeve

Në kuadër të fushëveprimit të projektit përfshiheshin: 3 module të trajnimit për OSHC-të në sferën e monitorimit, avokimi për politikat publike në nivel lokal, mbështetja e OSHC-ve në hartimin e analizave mbi politikat publike dhe realizimin e fushatave të avokimit, si dhe mbështetja e OSHC-ve në organizimin e takimeve publike dhe konsultimeve me publikun e gjerë.



#### Tregimi i suksesshëm

KDI ka qenë e suksesshme në përpjekjet për të krijuar Grupin Këshillues Lokal të OSHC-ve, dhe iniciimin e platformës për qeverisje lokale dhe avokimin për më shumë transparencë. Grupi i 11 OSHC-ve ka treguar përkushtim të vazhdueshëm dhe guxim në sfidimin e autoriteteve komunale. KDI ka arritur t'i ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme në sferën e avokimit dhe mekanizmave të raportimit.

#### Statistikat nga aktivitetet

Lloji i aktivitetit	Ekspozimi në media	Artikujt në gazeta	Tryezat	Takimet	Raportet studimore	Aktivitetet e monitorimit	Të tjera
Numri i aktiviteteve	18	14	2	28	8	114	

### Transparenca dhe llogaridhënia në prokurimin publik

Synimi i projektit ka qenë mbështetja e OSHC-ve për promovimin e transparencës dhe llogaridhënien në prokurimin publik. Përmes projektit është krijuar edhe një mekanizëm standard për vlerësimin e performancës së transparencës, dhe më pas është zhvilluar një raport analitik.





### *Grupi i shënjestruar*

Grupi i shënjestruar nga ky projekt përbëhet nga zyrtarë publik, administratorë, shtëpi mediale, biznese, prokurorë dhe qytetarë. Angazhimi i KDI ka qenë kritik për forcimin e kredibilitetit të autoriteteve publike, dhe për sigurimin e informacioneve të duhura për kompanitë, organizatat dhe publikun.

### *Fushëveprimi i shërbimeve*

Në kuadër të fushëveprimit të këtij projekti janë përfshirë: monitorimi i tri ministrive (Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Infrastrukturës). Për secilën ministri, KDI ka publikuar raporte të monitorimit të prokurimit publik dhe raste studimore përmes të cilave KDI ka identifikuar dobësitë kryesore në sistemin e prokurimit publik. Pas publikimit të analizës, KDI ka organizuar një fushatë të avokimit që ka pasur për qëllim të nxisë përmirësimin e gjendjes në sistemin e prokurimit.

### *Tregimi i suksesshëm*

Në vitin 2013, KDI ka vlerësuar se Ministria e Infrastrukturës ka shkelur procedurat e tenderimit pas nënshkrimit të kontratës në vlerë prej 8 milion euro për mirëmbajtjen e rrugëve. KDI ka ndikuar në këtë rast të kompanitë të cilat kanë qenë të diskriminuara gjatë gjithë procesit të tenderimit që të dërgojnë këtë çështje në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Për rrjedhojë, Ministria është detyruar të ndryshoj kriteret e tenderit duke ofruar hapësirë për operatorët tjerë që të garojnë në një proces transparent dhe të drejtë.



### *Statistikat nga aktivitetet*

Lloji i aktivitetit	Ekspozimi në media	Artikujt në gazeta	Tryezat	Takimet	Raportet studimore	Aktivitetet e monitorimit	Të tjera
Numri i aktiviteteve	7	2	7	13	8	44	Platforma tenderi im (4)

## **Pjesëmarrja qytetare për transparencë dhe llogaridhënie**

Synimi i projektit ka qenë të rrisë transparencën dhe llogaridhënien tek autoritet lokale në 6 komuna të rajonit të Prizrenit. KDI ka organizuar aktivitete të ndryshme për vlerësimin e punës së Kuvendeve Komunale, si: konsultime, takime dhe pjesëmarrje në seancat e kuvendeve.





### Grupi i shënjestruar

Grupi i shënjestruar nga ky projekt përbëhej nga anëtarët e kuvendeve komunale, OSHC-të lokale (së paku 10 nga secila komunë) dhe publiku i gjerë. Ideja e projektit ishte e dyanshme, dhe kishte për qëllim të rrisë presionin ndaj përfaqësuesve të zgjedhur për të dëgjuar më me kujdes shqetësimet e qytetarëve, dhe në anën tjetër të promovoj aktivizmin qytetar dhe pjesëmarrjen.

### Fushëveprimi i shërbimeve

Në kuadër të fushëveprimit të projektit janë përfshirë: hartimi i planit të punës për secilën komunë, organizimi i qytetarëve për dëgjimet buxhetore, hartimi i udhëzuesve për prokurim, inicicimi i fletënotimeve si mekanizëm për vlerësimin e performancës së autoriteteve lokale ekzekutive, si dhe përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore për vlerësimin e performancës së institucioneve të pushtetit lokal.

### Tregimi i suksesshëm

KDI ka raportuar dhe avokuar me sukses te autoritetet lokale të komunës së Prizrenit. Vendimi Kryetarit të Komunës që të shpërblej financiarisht administratorët dhe këshilltarët komunal në fund të vitit 2012, ka qenë një çështje specifike e shënjestruar nga projekti. Presioni i KDI ka ndikuar që institucionet përkatëse gjyqësore të hapin rastin, të hetojnë atë dhe përfundimisht të gjykojnë nëse vendimi i Kryetarit ka qenë i ligjshëm.



### Statistikat nga aktivitetet

Lloji i aktivitetit	Ekspozimi në media	Artikujt në gazeta	Tryezat	Takimet	Raportet studimore	Aktivitetet e monitorimit	Të tjera
Numri i aktiviteve	3	4	10	10	1	6	Broshura (2)

## Agjencionet e pa (varura) dhe ndërmarrjet publike në Kosovë

Synimi i projektit ka qenë të skanoj punën e agjencioneve të pavarura shtetërore dhe institucionet e pavarura. Më pas, ideja ka qenë të analizohen aktet juridike dhe dokumentet e brendshme në kuadër të fushëveprimit të këtyre institucioneve.

### Grupi i shënjestruar

Grupi i shënjestruar nga ky projekt përfshinte përfaqësues të këtyre institucioneve: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), Agjencioni Kundër Korrupsionit (AKK), Ombudspersoni, Fondi Pensional dhe shumë institucione të tjera të pavarura publike.





### *Fushëveprimi*

Në kuadër të fushëveprimit të projektit janë përfshirë: aktivitetet e hulumtimit përmes intervistave dhe raporti përfundimtar studimor i cili u është shpërndarë të gjitha palëve të interesuar.

### *Tregimi i suksesshëm*

KDI ka arritur të nxisë vëmendjen e Kuvendit të Kosovës që të trajtoj më me kujdes ndikimin politik në emërimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencioneve të pavarura.

### *Statistikat nga aktivitetet*

Ky projekt ka qenë i natyrës së hulumtimit studimor, dhe ka përfshirë 10 intervista e 2 fokus grupe. Produkti përfundimtar i KDI nga ky projekt ka qenë raporti studimor.

## **10 vite parlamentarizëm**

Synimi i projektit ka qenë analizimi i akteve juridike dhe raporteve të vlerësimit për performancën e Kuvendit të Kosovës.

### *Grupi i shënjestruar*

Grupi i shënjestruar nga ky projekt ishin zyrtarët e zgjedhur publik, administratorët dhe liderët e partive të cilët janë aktiv në skenën politike.



### *Fushëveprimi*

Në kuadër të fushëveprimit të projektit janë përfshirë: intervistat, hartimi dhe shpërndarja e raportit studimor te palët e interesuara.

### *Tregimi i suksesshëm*

Për herë të parë në Kosovë u bë një vlerësim i hollësishëm i punës së Kuvendit të Kosovës. KDI shpenzoi kohë dhe resurse të shumta për të përgatitur një projekt hulumtues objektiv. Ky projekt ka ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të brendshme të KDI në fushën e hulumtimeve. Gjithashtu, raporti përfundimtar ka shërbyer për OSHC-të si bazë e mirë për hulumtime.

### *Statistikat e aktiviteteve*

Ky projekt ka qenë studim hulumtues dhe ka përfshirë 16 intervista. Në fund të projektit KDI ka publikuar analizën dhe e ka shpërndarë atë me të gjitha palët e interesuara.

## **Zgjedhjet e lira dhe të drejta**

Synimi i projektit ka qenë të siguroj një proces zgjedhor të lirë dhe të drejtë, si dhe dalje më të madhe të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve. KDI ka shërbyer si organizatë udhëheqëse e rrjetit të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim", duke arritur të mobilizoj një rrjet të gjerë të vëzhguesve gjatë procesit zgjedhor, dhe më pas është angazhuar në procesin e reformës zgjedhore.



### *Grupi i shënjestruar*

Grupi i shënjestruar nga ky projekt ka qenë i përbërë nga 10 organizata të shoqërisë civile (OSHC), duke u zgjeruar më pas në 70 OSHC nga të gjitha komunat, duke përfshirë ato të banuara me shumicë Serbe, me të cilat është punuar në rekrutimin e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër.

### *Fushëveprimi*

Llojet e shërbimeve përfshinin: angazhimin e 1.600 vëzhguesve afatshkurtër, dhe 50 vëzhguesve afatgjatë, 72 trajnime për vëzhguesit afatshkurtër, të zgjedhjeve, 12 trajnime për vëzhguesit afatgjatë për fushatës parazgjedhore, 23 aktivitete gjatë fushatës për edukimin e votuesve, dhe takime të ndryshme rreth reformës zgjedhore me përfaqësues të partive politike.

### *Tregimi i sukseshëm*

Ky projekt ka qenë i dobishëm veçanërisht për trajnimin e pjesëtarëve të komunitetit Serb për vëzhgimin e zgjedhjeve. Kjo ka ndikuar tërthorazi në daljen më të madhe të qytetarëve Serb në zgjedhje, sidomos në pjesën veriore të vendit. Në përgjithësi, Demokracia në Veprim si koalicion ka qenë më e përgatitur dhe më përfaqësuese në raport me hisedarët kryesor të zgjedhjeve.

### *Statistikat e aktiviteteve*

Lloji i aktivitetit	Takime periodike	Monitorimi i takimeve të KQZ-së	Konf. të Mediave	Vëzhgimi i zgjedhjeve në terren	Monitorimi i Mediave	Trajnime me minoritete Serbe	Broshura për edukim të votuesve
Numri i aktiviteteve	14	40	5 (gjatë ditës së zgjedh.)	1600 vëzhg., 130 zyrtarë	4 TV në kanale shqip dhe 5 në serbisht	3	2

## **Gratë për të drejta dhe përgjegjësi më të mëdha në zgjedhje**

Synimi i projektit ka qenë forcimi i rolit të gruas në proceset zgjedhore. Përmes koalicionit të OSHC-ve Demokracia në Veprim, KDI ka dizajnuar një program të veçantë për edukimin e votuesve, duke kontribuar kështu në avancimin e kornizën ligjore duke e bërë atë më të përgjegjshëm në raport me nevojat e grave, dhe duke implementuar fushatën mediale "Dil dhe Voto" e cila ka shënjestruar veçanërisht gratë.

### *Grup i shënjestruar*

Grupi i shënjestruar nga ky projekt përfshinte gratë me të drejtë vote, komisionerët zgjedhor lokal dhe vëzhguesit e zgjedhjeve. Për zgjedhjet e vitit 2013 KDI ka punuar me 7 OSHC partnere për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të ndërlidhura me barazinë gjinore.

### *Fushëveprimi*

Në kuadër të fushëveprimit të projektit është përfshirë: një rritje e lehtë e numrit të grave që dalin në zgjedhje, gratë në përgjithësi të jenë më të njoftuara në lidhje me procesin zgjedhor, gratë të kenë rol më të madh në administrimin e zgjedhjeve në nivel komunal, zvogëlimi i rasteve të votimit



familjar, dhe rritja e përgjegjësisë nga ana e institucioneve relevante për trajnimin e grave në sferën e zgjedhjeve,

### *Tregimi i suksesshëm*

Tërthorazi KDI ka rritur vetëdijen politike të elektoratit për të fuqizuar gruan në mënyrë që ajo të jetë më aktive në politikë. Nëse shikohen zgjedhjet lokale të vitit 2009, vetëm 4 gra kanë garuar për kryetare të komunës dhe asnjë nga to nuk ka arritur të zgjedhet. Me influencën e KDI, kjo gjendje ka ndryshuar, dhe në zgjedhjet e vitit 2013 kanë qenë 9 gra kandidatë për kryetare të komunës, dhe njëra prej tyre është zgjedhur në Komunën e Gjakovës.



### *Statistikat e aktiviteteve*

Lloji i aktivitetit	Debatet televizive	Reklamat televizive	Fushata	Broshurat	Grantet e vogla	Trajnimet
Numri i aktiviteteve	16	2	1	1	7	3

## **Monitorimi dhe avokimi për zbatimin e planeve lokale të veprimit të komunitetit RAE në Prizren**

Synimi i projektit ka qenë nxitja e aktivizmit të pjesëtarët e komunitetit RAE të Prizrenit, me qëllim të fuqizimit të rolit të tyre në bërjen e politikave. Qasja e KDI ka qenë e orientuar drejt identifikimit të çështjeve lokale me interes për komunitetet pakicë dhe mobilizimi i tyre për të avokuar për interesat e përbashkëta.

### *Grupi i shënjestruar*

Grupi i shënjestruar nga ky projekt përfshinte pjesëtarët e komuniteteve pakicë dhe autoritetet lokale të Prizrenit. KDI ka shënjestruar veçanërisht lagjet e banuara nga komuniteti RAE, dhe i ka mbështetur ata që të mobilizohen për të ushtruar presion tek autoritetet lokale, në mënyrë që këto të fundit të adresojnë shqetësimet dhe kërkesat e tyre.



### *Fushëveprimi*

Në kuadër të fushëveprimit të projektit janë përfshirë: vlerësime të detajuara në terren me qëllim të identifikimit të çështjeve të ndjeshme me interes për komunitetet pakicë, hartimi dhe prezantimi i 12 dokumenteve që ofrojnë zgjidhje për politikën publike që adresojnë çështjet me interes për komunitetet pakicë, diskutimet publike me fshatra me përfaqësuesit e komuniteteve pakicë në institucionet komunale, dhe ngritja e vetëdijes në lidhje me çështjet me interes për komunitetet pakicë.



### *Tregimi i suksesshëm*

KDI ka pasur ndikim pozitiv në mobilizimin e pjesëtarëve të komunitetit RAE. Shumë çështje me interes për këtë komunitet që kanë kërkuar aktivizim qytetar janë adresuar tek institucionet përkatëse. KDI është treguar e suksesshme në kultivimin e një sensi të aktivizmit qytetar dhe optimizmit për përfaqësim të barabartë dhe të drejtë të pjesëtarëve të komunitetit RAE.

### *Statistikat e aktiviteteve*

KDI ka organizuar shumë takime me mësimdhënës, prindër dhe udhëheqës politik, e nga të cilat janë incizuar protesta, peticione dhe tryeza të rumbullakëta për të diskutuar mënyrën se si mund të integrohen komunitetet pakicë në zbatimin e planit komunal të veprimit si dhe proceset vendimarrëse në përgjithësi.

## **Rritja e aktivizmit në komunitetet lokale dhe në vendimarrje**

Synimi i projektit ka qenë rritja e aktivizmit qytetar dhe promovimi i rolit të tyre në proceset vendimarrëse në rajonin e Prizrenit, duke mbuluar kështu 5 komuna që karakterizohen me diversitet etnik dhe kulturor. Përmes identifikimit të çështjeve kryesore me interes në terren, roli i KDI ka qenë në nxisë banorët që të marrin rol më aktiv për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme.

### *Grupi i shënjestruar*

Projekti ka pasur në shënjestër banorët, autoritetet komunale dhe OSHC-të lokale.

### *Fushëveprimi*

Në kuadër të fushëveprimit të projektit janë përfshirë: hulumtimi në terren për të identifikuar çështjet me interes të përbashkët për qytetarët, mobilizimi i përfaqësuesve të secilit komunitet për të avokuar për ndryshime, forumet publike me përfaqësuesit e zgjedhur me qëllim të ndërtimit të debatit konstruktiv, dhe puna me media me qëllim të rritjes së vetëdijësit të publikut.



### *Tregimi i suksesshëm*

KDI ka organizuar aktivitete të ndryshme që kanë ndikuar tek qeveria që të formojnë komisionin ndërministror për të adresuar çështjen e kërcënimit nga insektet vdekjeprurëse dhe për të ndërmarrë masa urgjente për të parandaluar rrezikun e vdekjes për qytetarët e Kosovës. Projekti ka pasur ndikim pozitiv, sepse si rezultat këtë vit nuk ka pasur raste të sulmeve nga insektete vdekjeprurëse.

### *Statistikat e aktiviteteve*

KDI ka organizuar 6 tryeza të rumbullakëta për identifikimin e çështjeve me interes në nivel lokal, ka themeluar grupet bërthamë (bazë për mobilizim dhe avokim, ka mbajtur 2 konferenca për shtyp, 1 debat televiziv, ka botuar 2 editoriale, ka shtypur broshurat, ka organizuar takime me zyrtarët e institucioneve të nivelit lokal dhe qendror, dhe në fund ka organizuar një tryezë të rumbullakët.



## Struktura organizative

### Bordi i Drejtorëve

Bordi i KDI përbëhet nga pesë (5) aktivistë të shoqërisë civile. Kryesuese e bordit është Violeta Zeka e cila është ndër themelueset e KDI, ndërkohë që katër anëtarët tjerë janë: Arben Shala, Enver Robelli (kolumnist), Jehona Lushaku (Ligjëruese në Universitet) dhe Bashkim Gashi (përfaqësues i një organizate të shoqërisë civile).

### Anëtarët e stafit

Në total KDI ka 16 anëtarë të stafit, të lokalizuar në Prizren dhe Prishtinë. Pjesa dërmuese e stafit kanë përvojë të gjatë në pjesëmarrjen qytetare, qeverisjen lokale, zgjedhjet dhe aktivitetet kundër korrupsionit.

#### *Profili dhe ekspertiza e anëtarëve të stafit – viti 2013*

##### **Ismet Kryeziu, Drejtor Ekzekutiv**

Ka përvojë të gjatë në shoqëri civile që nga viti 2000 përfshirë në aktivitetet të organizimit të komunitetit, qeverisjen lokale dhe zgjedhjet, monitorimin e institucioneve publike, barazi gjinore, etj. Ai aktualisht udhëheq OSHC-në që është në krye të Koalicionit të Shoqërisë Civile për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Demokracia në Veprim.

##### **Valmir Ismaili, Koordinator i programeve**

Valmiri ka 10 vjet përvojë në shoqërinë civile, dhe atë kryesisht me projektet që ndërlidhen me demokratizimin e Kuvendit dhe proceset zgjedhore. Ai ka kontribuar në ndërtimin e koalicionit për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe monitorimin e avokimin në Kuvendin e Kosovës. Gjatë viteve të fundit, Valmiri ka koordinuar katër programet kryesore të KDI dhe ka ndihmuar në përmbushjen e objektivave të organizatës.

##### **Driton Selmanaj, Menaxher i Projektit**

Dritoni është analist i politikave, dhe njohës i çështjeve që ndërlidhen me monitorimin dhe raportimin mbi punën e institucioneve ekzekutive dhe ligjvënese, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Me ekspertizën e tij, ai ka kontribuar në KDI (gjatë pesë viteve të fundit) në përgatitjen e disa hulumtimeve dhe analizave mbi politikat publike.

##### **Merita Mustafa, Menaxhere e Projektit**

Merita ka mbi pesë vite përvojë në projektet kundër korrupsionit, monitorimit të prokurimit publik dhe avokimit për ndryshimin e legjislacionit. Përgjatë viteve të fundit ka zhvilluar dhe implementuar projektet e KDI kundër korrupsionit, duke bashkëpunuar ngushtë me zyrën e prokurorit të shtetit, policinë dhe agjencionin kundër korrupsionit, me qëllim të adresimit të çështjeve që kanë sfiduar sundimin e ligjit në Kosovë.

##### **Jetmir Bakija, Menaxher i Projektit**

Jetmiri është aktivist i shoqërisë civile, që ka punuar në projekte të ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që kanë pasur në fokus pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimarrëse. Aktualisht është i angazhuar në disa projekte të financuara nga USAID, që kanë për synim mbështetjen e OSHC-ve për avokim në bërjen e politikave.

##### **Shqipe Gjocaj, Menaxhere e Projektit**





Shqipja ka dy vite përvojë në promovimin e barazisë gjinore, të drejtave të grave dhe pjesëmarrjes së tyre në procesin zgjedhore. Shqipja ka menaxhuar dhe drejtuar koalicionin e OSHC-ve të grave që ka qenë i angazhuar në edukimin e votuesve, avokimin dhe lobimin për të siguruar përfaqësim të balancuar të meshkujve dhe femrave. Ajo ka qenë aktive në publikimin e kolumneve mbi çështjet që ndërlidhen me barazinë gjinore dhe korrupsionin në gazetatat ditore lokale. Më herët ka punuar në sferën e prokurimit publik, dhe ka qenë e përfshirë në disa iniciativa kundër korrupsionit.

**Naim Canhanaj, Menaxher i Projektit**

Naimi ka përvojë solide në qeverisje lokale për rajonin e Prizrenit. Që nga viti 2010 ka ndihmuar sekretariatit të koalicionit të OSHCve Demokracia në Veprim. Ai ka shërbyer si pikë ndërlidhëse në mes të shoqërisë civile dhe zyrtarëve publik në shumë komuna, duke i ndihmuar KDI-së që të nxisë pjesëmarrjen qytetare në bërjen e politikave.

**Isuf Zejna, Hulumtues**

Isufi është i specializuar në monitorimin e prokurimit publik dhe ka trajnuar OSHC-të vendore për mekanizmat e raportimit. Sferat tjera të ekspertizës përfshijnë kundër korrupsionin, analizat mbi politikat publike, dhe menaxhimin e projekteve në përgjithësi. Në KDI ka shërbyer mbi 5 vite.

**Besian Bicurri, Hulumtues**

Me përvojë në metodologjinë e hulumtimeve për organizimin dhe financimin e partive politike. Besiani ka monitoruar të hyrat e partive politike dhe ka avokuar për transparencë më të madhe në financat e partive politike. Me mbështetjen e kolegëve nga projektet kundër korrupsionit, Besiani ka avokuar për ndryshimin e legjislacionit në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe raportim i rregullt nga ana e partive politike.

**Besnik Ramadanaj, Marrëdhëniet me media**

Duke qenë më herët i angazhuar si gazetar për disa gazeta ditore, Besniku ka ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve të KDI me publikun dhe mediat. Besniku ka qenë i përfshirë edhe në hulumtimet në terret për projektet kundër korrupsionit, duke realizuar shumë intervista me grupet e shënjestruara, dhe atë kryesisht me zyrtar të zgjedhur. Me kërkesë të menaxherit të programit, Besniku ka mbështetur aktivitetet kundër korrupsionit përmes hulumtimeve dhe shpërndarjen e informatave relevante me mediat.

**Arben Hoxha, hulumtues**

Arbeni është duke punuar në programin për qeverisje lokale në rajonin e Prizrenit. I është bashkangjitur KDI në Shkurt të vitit 2012, dhe është përgjegjës për monitorimin e punës së Kuvendeve Komunale dhe komiteteve, si dhe mbështetjen në hartimin analizave mbi politikat publike.

**Vjollca Vogël, Menaxhere e Financave**

Vjollca ka mbi 15 vjet përvojë në menaxhimin e financave, dhe është përgjegjëse për një portfolio financiare të shumëllojshëm, duke menaxhuar njëkohësisht disa projekte, që së bashku e tejkalojnë qarkullimin prej 500.000 Euro.

**Leonora Cikaj, Asistente e Financave**

Duke qenë e angazhuar në KDI që nga vitit 2008, Leonora ka përvojë në administratë dhe financa. Ajo asiston në menaxhimin e financave të projekteve dhe ruajtjen e regjistrave të kontabilitetit.





### *Stafi i ri i angazhuar nga KDI*

#### **Edita Salihu, Koordinator e programeve**

Duke qenë e angazhuar për shumë vite me Medical Corps dhe NDI, Edita ka pëvojë të gjatë me shoqërinë civile. Nga përvoja me menaxhimin e projekteve në sferën e qeverisjes lokale dhe zgjedhjeve, ajo ka shkathtësi të forta të menaxhimit.

#### **Visar Sutaj, Menaxher i Projektit**

Visari është i angazhuar në shoqërinë civile për më shumë se 10 vite, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit. Është trajnuar për organizim të komunitetit në SHBA, ka pëvojë në sferën e zgjedhjeve, kundër korrupsionit dhe sundimit të ligjit, dhe në projekte të tjera të mbështetura nga USAID.

#### **Artan Canhasi, Hulumtues i lartë**

Artani ka pëvojë të gjatë me organizatat ndërkombëtare si OSBE, NDI dhe EULEX. Ai është përgjegjës për të zhvilluar hulumtimin, si dhe draftin e prezantimin e raportit mbi Sistemin Nacional të Integritetit (NIS).

#### **Ramadan Klisurica, Hulumtues i lartë**

Ramadani është i certifikuar nga agjencione dhe organizata të ndryshme (duke përfshirë NDI) në fushën e zhvillimit të demokracisë dhe ndërmarrjeve sociale në nivel lokal. Ka shërbyer si ekspert në shumë projekte të USAID (si DEMI), dhe ka kontribuar në dizajnimin dhe implementimin e sesioneve të trajnimit dhe mentorimit për qeverisje lokale.

#### **Haxhi Seferqaj, Asistent i projektit**

Haxhiu ka pëvojë me shumë projekte të USAID (si BEEP), ku ka kontribuar në dizajnimin dhe implementimin e sesioneve të trajnimit dhe mentorimit për qeverisje lokale dhe sektorin e biznesit, duke përfshirë përgatitjen e planeve të biznesit, marketingun, menaxhimin e financave etj.

#### **Nita Tafarshiku, Asistente e administratës dhe financave**

Nita ka punuar për shumë vite në OSHC-të lokale dhe ka eksperiencë të gjatë në sferën e financave. Nita është përgjegjëse për procedimin e pagesave dhe mirëmbajtjen e dokumenteve financiare.

#### **Qendresa Mrasori, Hulumtuese**

Qendresa i është bashkangjitur KDI rishtazi, pas angazhimit si hulumtuese në Kuvendin e Kosovës. Ajo ka qenë e përfshirë në hulumtimet që ndërlidhen me çështjet e qeverisjes lokale dhe ka ndihmuar në avancimin e përpjekjeve të KDI në kuadër të këtij programi. Gjithashtu, Qendresa ka ndihmuar menaxherin e projektit në vlerësimin e performancës së institucioneve lokale përmes indikatorëve dhe metodologjisë së zhvilluar brenda organizatës.

#### **Diellëza Xhemali, Koordinator e Projektit**

Ka përfunduar studimet në Marketing, dhe tani është në vitin e fundit të përfundimit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës. Ajo ka pëvojë në vëzhgimin e zgjedhjeve në vitin 2014. Me vullnetar të mirë dhe talent, Diellëza ka potencial për tu zhvilluar dhe kontribuar në zhvillimin e mëtutjeshëm në KDI.

#### **Bora Duli, Hulumtuese**

Bora është studente e Fakultetit Juridik në Shkollën Evropiane të Drejtësisë dhe Qeverisjes. I është bashkangjitur KDI-së si pjesë e programit të praktikantëve dhe është angazhuar në programin e zgjedhjeve. Ajo ka qenë e përfshirë në futjen e të dhënave nga rezultatet e zgjedhjeve në data bazë dhe në identifikimin e parregullsive të zgjedhjeve në raportet e vëzhgimit të dërguara nga



vëzhguesit e Demokracisë në Veprim. Në kohët e fundit, Bora është e angazhuar si hulumtuese (junior) pasi ka treguar punë të mirë dhe aftësi në zhvillimin e projekteve të organizatës.

## **Origjina e fondeve**

Gjatë vitit fiskal 2013 KDI është mbështetur kryesisht nga donatorët ndërkombëtar. Në total 48% e donatorëve kanë qenë ndërkombëtar, 47% nga agjencitë zhvillimore dhe 5% vendorë. Donatorët kryesorë të KDI për vitin 2013 kanë qenë: USAID në Kosovë, Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ambasada Mbretërore Norvegjeze, The Olof Palme International Centre – OPIC, National Democratic Institute – NDI, Kosovo Foundation for Open Society dhe Caritas Switzerland.

Ne u jemi shumë mirënjohës për mbështetjen e tyre gjeneroze, e cila i mundëson KDI-së të përmbush misionin e saj.



## Pasqyrat financiare

Kjo pasqyrë financiare është lëshuar nga menaxhmenti i KDI me 16 maj, 2014.

### Deklarata e bilancit 31.12.2013

<b>ASETET</b>	Euro	<b>DETYRIMET</b>	Euro
Para të gatshme	38,933.85	Llogaritë e arkëtueshme	0.00
Llogaritë e pagueshme	-	Grantet e pagueshme	-
Të hyrat e arkëtueshme nga interesi	-	Të ardhurat e shtyera	-
Invertari	-	Hipoteka dhe detyrimet e pagueshme të interesit	-
Shpenzimet parapaguara	68.00	Detyrimet tjera	10,341.28
Investimet:		<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>10,341.28</b>
Letrat me vlerë	-	<b>Bilanci i fondeve</b>	
Toka, ndërtesa dhe pajisjet	-	Bilanci i fondeve nga 1 Janari, 2013	<b>63,310.39</b>
Të tjera (Kreditë për klientë)	-	Mbetje (nga gjendja e të hyrave)	(34,649.82)
Asetet tjera	-	<b>Bilanci total i fondeve:</b>	<b>28,660.57</b>
<b>Totali i asetëve</b>	<b>39,001.85</b>	<b>Bilanci total i obligimeve dhe fondeve</b>	<b>39,001.85</b>



## Pasqyra e të hyrave 01.01.-31.12.2013

<b>Të hyrat</b>	<b>Euro</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Euro</b>
Kontributet, dhuratat, grantet	<b>618,235.49</b>	Shërbimet programore	509,623.98
Pagesat dhe të hyrat nga aktivitetet ekonomike		Menaxhmenti dhe Administrimi	138,506.06
Borxhe		Shpenzimet tjera	9,357.30
Dividenta dhe interesi		<b>Shpenzimet e përgjithshme:</b>	<b>657,487.34</b>
Qiratë		<b>Të hyrat neto nga operativa:</b>	<b>(34,649.82)</b>
Të hyra të tejra nga investimet			
Shitja e asetëve			
(minus kostoja e shitjes)		Shpenzimet e taksave	0,00
Të hyrat nga ngjarjet speciale			
Shitja bruto e inventarit			
(minus kostoja e mallrave (të mirave) të shitura)			
Të hyrat tjera	4,602.03		
<b>Të hyrat e përgjithshme:</b>	<b>622,837.52</b>	<b>Të hyrat neto:</b>	<b>(34,649.82)</b>

## Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin 2013

<b>RRJEDHA E PARASË</b>	<b>EURO</b>
Bilanci në fillim të periudhës	<b>66,454.12</b>
Fondet e pranuar nga donatorët gjatë vitit 2013	<b>622,999.72</b>
Shpenzimet nga fondet (pagesat) gjatë vitit 2013	<b>(650,084.89)</b>
Fondet e kthyer te donatorët gjatë vitit 2013	<b>(435.10)</b>
<b>Bilanci vjetor për vitin 2013</b>	<b>38,933.85</b>



Pasqyra e të hyrave nga donatorët (2013)

Emri i donatorit	Fondet e transferuara nga viti 2012	Fondet e kthyera te donatorët-2013	Të hyrat gjatë vitit 2013	Totali fondeve për vitin 2013
KDI	(614.51)		4,602.03	3,987.52
OPIC	376.49		48,380.52	48,757.01
KCSF	5,040.40	(176.09)		4,864.31
BTD	6,307.64			6,307.64
CRINIS	34,380.81	(214.42)		34,166.39
Ambasada e Britanisë së Madhe	17,611.79		17,436.00	35,047.79
UNDEF			106,734.24	106,734.24
KFOS			3,500.00	3,500.00
Ambasada e SHBA-ve		( 44.59)	12,408.88	12,364.29
Caritas			6,999.98	6,999.98
NDI			94,865.91	94,865.91
OPIC			38,876.69	38,876.69
KFOS			13,380.00	13,380.00
KFOS			7,550.00	7,550.00
USAID			177,126.59	177,126.59
Ambasada e Norvegjisë	207.74		31,831.87	32,039.61
Ambasada e Britanisë së Madhe			25,000.00	25,000.00
Ambasada e Britanisë së Madhe			34,579.91	34,579.91
<b>Totali</b>	<b>63,310.36</b>	<b>( 435.10)</b>	<b>623,272.62</b>	<b>686,147.88</b>



## Shpenzimet për vitin 2013

<b>Shpenzimet programore</b>	<b>509,623.98</b>
Pagat	315,651.96
Shpenzimet për programet	183,864.18
Shpenzimet e drejtpërdrejta	10,107.84
<b>Shpenzimet e menaxhmentit/administrimit</b>	<b>138,506.06</b>
Pagat	51,751.06
Shpenzimet operationale	86,755.00
<b>Shpenzimet tjera</b>	<b>9,357.30</b>
Shpenzimet e tjera	9,357.30
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>657,487.34</b>





### Totali i fondeve nga donatorët (2013)

Emri i donatorit	Totali i fondeve 2013	Totali i shpenzimeve	Fondet e transferuara nga viti 2013 në vitin 2014
KDI	3,987.52	2,183.69	1,803.83
OPIC	48,757.01	47,394.10	1,362.91
KCSF	4,864.31	4,864.26	0.05
BTD	6,307.64	3,672.45	2,635.19
CRINIS	34,166.39	34,166.39	0.00
Ambasada e Britanisë së Madhe	35,047.79	35,030.15	17.64
UNDEF	106,734.24	75,582.12	31,152.12
KFOS	3,500.00	3,500.02	(0.02)
Ambasada e SHBA-ve	12,364.29	12,367.29	(3.00)
Caritas	6,999.98	6,999.98	0.00
NDI	94,865.91	95,084.63	(218.72)
OPIC	38,876.69	38,405.86	470.83
KFOS	13,380.00	9,796.55	3,583.45
KFOS	7,550.00	7,549.13	0.87
USAID	177,126.59	158,144.96	18,981.63
Ambasada e Norvegjisë	32,039.61	31,831.09	208.52
Ambasada e Britanisë së Madhe	25,000.00	49,999.95	(24,999.95)
Ambasada e Britanisë së Madhe	34,579.91	40,914.71	(6,334.80)
<b>Totali</b>	<b>686,147.88</b>	<b>657,487.34</b>	<b>28,660.54</b>